# AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ``VJEN``

## NENI 1

Shoqeria private ''VJEN'' formohet nga themeluesja Vangjeli Ndoni, e bija e Todit, me datl. 1956, banuese ne Grabian, Lushnje, me arsim te larte.

## NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne Grabian, Lushnje.
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me zgjerimin e aktivitetit me miratimin e ortakut te vetem.

## NENI 3

Shoqeria ka si objekt veprimtarie: Agrotregeti per pesticide, plehra kimike, farna dhe materiale te tjera e sherbime ne bujqesi.

## NENI 4

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj me afat mbi 12 vjet te marre si vite kalendarike duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregetar.

## NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.
Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem.
Shoqeria mund te shtoje ose te pakesoje kapitalin e saj me miratimin nga ortakut themelues.

## NENI 6

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte ortaku i vetem, organi vendimor.
Shoqeria mund te administrohet nga:
- Nje administrator unik i vetem aktualisht zonja Vangjeli Ndoni.
- Nje keshill administrativ.
- Dy administrator me nje firme te perbashket ose te vecante per secilin.

## NENI 7

Shtimi i ortakeve:

- Kur ortaku i vetem eshte dakort, qe te behen shtesa kapitali me ane te personave te tjere, qe keta te konsiderohen ortake duhet te veprohet keshtu:
- Se pari meret vendim nga ortaku i vetem, ku shqyrtohet kerkesa e te interesuarit, behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te derdhe ortaku i ardhshem.
- Se dyti behet regjistrimi ne librin e ortakut, ku shkruhet emeri i plote i ortakut te ri dhe kuota ne kapitalin social.
- Veprimi i bashkimit te ortakut te ri duhet te behet me nje akt noterial.

THEMELUESI I SHOQERISE

*VANGJELI NDONI*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA LUSHNJE
Nr. 73 i Rep.
Nr. 72 i Kol.

Lushnje me 20/1/1997

## V E R T E T I M

*Sot me daten 20/1/1997, para meje noteres Manushaqe Sharka u paraqit peronalisht zonja Vangjeli Ndoni, e bija e Todit, me datl.1956, banuese ne Grabian, Lushnje, e njohur nga meje noteres me zotesi te plote juridike per te vepruar, me identitetin e te cilit u njoha nepermjet leter njoftimit perkates, e cila deklaroi se ka hartuar jashte kesaj zyre statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ``VJEN'', Lushnje, e cila me vullnetin e tij te lire dhe te pavarur e nenshkruan ate para meje.*

*Sa me siper vertetohet edhe prej meje noteres.*

N O T E R E

*MANUSHAQE SHARKA*

# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## `` VJEN ``

### *FORMA. BAZA JURIDIKE. SELIA.*

### NENI 1

Shoqeria private ``VJEN``formohet nga themeluesja:
Vangjeli Ndoni, e bija e Todit, me datl.1956,banuese ne Grabjan, me arsim te larte.

### NENI 2

Shoqeria eshte person juridik, dhe eshte krijuar ne perputhje me legjislacionin shqipetar dhe si e tille e fillon aktivitetin me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar.

### NENI 3

Selia e shoqerise eshte ne Grabjan, Lushnje.
Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, me zgjerimin e aktivitetit, me mireatimin ortakut te vetem.

### NENI 4

Shoqeria e zhvillon aktivitetin ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statusin e saj ne teritorin e Shqiperise dhe jashte saj.
Shoqeria mund te krijoje filjale ne vende te tjera ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

### NENI 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit te investuar ne te.

### *LIBRI I SHOQERISE*

### NENI 6

Per te precizuar e per te saktesuar veprimtarine e vet ekonomike dhe mardhenjet e punes, shoqeria do te cele librin e vet, i cili do te quhet libri i shoqerise.

## *KONFIDENCIALITETI*

### NENI 7

Ortaku vete, dhe per personat e pranuar ne shoqeri, bie dakort qe te mos i ekspozoje asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe, si dhe planet dhe qellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.

### NENI 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat e tjera qe nxiren nga shoqeria dhe te destinuara per te tretet, si letrat, faturat, lajmerimet dhe publikimet e ndryshme, duhet te tregojne lexueshem emerin e shoqerise dhe pas tij fjalet `` Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar `` ose inicialet `` SHPK ``, kapitalin themeltar dhe emerin e administratorin.

### NENI 9

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise se saj:
Agrotregeti per pesticide,plehra kimike, farna dhe materiale te tjera dhe sherbime ne bujqesi.

## *KOHEZGJATJA E SHOQERISE*

### NENI 10

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj me afat mbi 12 vjet te marre si vit kalendarik, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregetar.

## *KAPITALI THEMELTAR*

### NENI 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.
Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaku i vetem.
Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj me miratimin e ortakut thmelues.

### NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve ( negoftese do te kete te tille ne te ardhmen ), gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund te transferohen edhe te treteve me miratimin e ortakut te vetem.
Ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve si dhe rruge trashegimie. Transferimet e pjeseve dhe kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

## STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### NENI 13

SHQIPERISE ... SHQIPERISE LUSHTA

Shoqeria do ta konsideroje qendren e vet ne si shoqeri nene, e cila rast pas rasti do te hapet edhe me filjale te tjera, ose shoqeri te perbashketa ne te gjitha ato vende ku do te shikoje interes ne permbushjen e qellimit te saj, ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

### NENI 14

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte ortaku i vetem, organi vendimor.

Shoqeria mund te administrohet nga:

- Nje administrator unik, i vetem aktualisht zonja Vangjeli Ndoni.
- Nje keshill administrativ.
- Dy administrator me nje firme te perbashket ose te vecante per secilin.

### NENI 15

Administratori ose administratoret negoftese do te kete, mund te jene ose jo ortake sipas percaktimit te ortakut te vetem.

Administratori shkarkohet me vendim te ortakut ose kur jep vete doreheqjen.

### NENI 16

Administratori unik dhe ai i autorizuar, i ka te gjitha kopetencat per te vepruar ne mardhenje me te trete ne emer te shoqerise dhe ne te gjitha rethanat.

Ai ka te drejte te marre pjese ne shitje, ne blerje, ne procedurat e falimentimit, te hartoje kontrata te karaktereve te ndryshme, asikuracione, te tjetersoje pasuri te lujiteshme dhe te palujiteshme, te hape llogari rrjedhese prane bankave shqiptare dhe te huaja si dhe te depozitoje dhe te huaje para, te perfaqsoje shoqeine ne mardhenje me te tretet dhe ne organet gjyqesore dhe administrative etj.

## LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

### NENI 17

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel ose librave te tjere edhe keto libra:

- Libri i ortakut ne te cilen shenohet emeri i plote i tij dhe kuota e kapitalit themeltar.
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit vendimor.
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit administrativ.

*BILANCI*

NENI 18

Bilanci mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti, ku i pari do te jete perjashtimisht me 31 dhjetor te vitit 1997.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel i autorizuar nga ortaku i vetem miratohet nga ai, miratimi i ketyre dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej kater muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

*DIVIDENTET*

NENI 19

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te egzistences se fitimeve, percaktohet pjesa qe i takon ortakut themelues ne formen e dividentit mbi fitimin.

Ky fitim perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domozdoshem te percaktuar nga ortaku, te fondeve te tjera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tjeter jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

*SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE*

NENI 20

Shoqeria prishet kur ka nje prishje te parakoheshme per arsye te parashikuara ne ligj.

NENI 21

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi ortaku cakton nje ose disa likujdues te cilet i paraqesin asj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit ortaku vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates(nese ka te tille), likujduesi ndan kapitalin per ortakun themelues.

*MARDHENJET PER PUNESIM*

NENI 22

Kriteret e pergjithshme te punesimit te personave te tjere, numerin e tyre kufijte e pageses dhe detyrat e secilit ne shoqeri percaktohet nga ortaku i vetem.

Punesimi i personave ne shoqeri kryhet mbi bazen e kontrates individuale te punes te hartuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## NENI 23

Shoqeria mer persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjithe te punesuarit ne te ndersa keta te fundit duhet te pranojne kete statut.

Te punesuarit pergjigjen simbas ligjit dhe sipas ketij statuti per mos zbatimin e detyrave dhe demeve qe ata i shkatojne shoqerise.

QE SEARK LUSHNJE

## NENI 24

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate egzistences se shoqerise, ose gjate periudhes se likujdimit, qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve do te tentohet te zgjidheen me mirekuptim, ne te kundert do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kopetente shqiptare konforme legjislacionit shqiptar.

## *DISPOZITA TE FUNDIT*

## NENI 25

Shtimi i ortakeve :

Kur ortaku i vetem eshte dakort qe te behen shtesa kapitali me ane te personave te tjere, qe keta te fundit te konsiderohen ortake duhet te veprohet keshtu:

- Se pari merret vendim nga ortaku i vetem, ku shqyrtohet kerkesa e te interesuarit, behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te derdhe ortaku i ardhshem.
- Se dyti behet regjistrimi ne librin e ortakut ku shkruhet emeri i plote i ortakut te ri dhe kuota ne kapitalin social.
- Veprimi i bashkimit te ortakut te ri duhet te behet me nje akt noterial.

## NENI 26

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve te meteishme me ane amedamentesh sa here qe e sheh te arsyeshme ortaku themelues i kesaj shoqerie.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behet ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen behet vete nxjerrika e ketij statuti. Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

Ky statut eshte hartuar ne pese kopje shqip dhe pasi lexohet dhe gjendet sipas vullnetit te pales nenshkruhet prej tij rregullisht.

**ORTAKU I VETEM**

*VANGJELI NDONI*

Ndoni

SH P K " V J E N "

Adress: Grabian Lushnje

SHQIPËRI-ALBANIA

T i r a n ë ____________________

V E N D I M

Sot më dt.26.2.1997, unë ortake e vetme dhe administratore e Shoqërisë SHPK " VJEN", Vangjeli Ndoni , duke patur parasysh rritjen e aktivitetit të shoqërisë:

V E N D O S A

Ndryshimin e statutit të kësaj shoqërie, duke shtuar dy aktivitet të ri edhe " Mulli bloje".

Ky vendim i bashkangjitet statutit dhe është pjesë e pandarë e tij.

ORTAKE E VETME

/ Vangjeli Ndoni /

"V J E N "

GRABIAN LUSHNJE6-ALBANIA

Republika e Shqipërisë
NOTERIA
Nr. Rep. 661.

VERTETIM

Sot më datë 28.10.1997 para meje NOTERE Amila Gjermeni u paraqit Vangjel Ndoni i njohur prej meje, i cili deklaroi se eshtë perpiluar ky vendim me vullnetin e lirë të tij dhe unë Noterja e vertetoj

NOTERE
Amila Gjermeni